

DISKRIMINIM, PERSEKUTIM, MARTIRIZIM:
TË NDJEKIM KRISHTIN SË BASHKU

Konsultim Global | 1 - 5 nëntor 2015 | Tiranë, Shqipëri

MESAZHI I KONSULTIMIT

4 nëntor 2015

“Dhe nëse vuan një gjymtyrë, të gjithë gjymtyrët vuajnë bashkë; kurse po të nderohet një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të.”

(1 Korintasve 12:26)

1. Për herë të parë në historinë moderne të Krishterimit, përfaqësues dhe udhëheqës të lartë nga tradita të ndryshme kishtare mbledhen për të dëgjuar dhe mësuar nga kishat dhe të krishterët e persekutuar në botë dhe për t'u qëndruar pranë atyre.
2. Kjo mbledhje globale me 145 pjesëmarrës ndodhi nga 2-4 nëntor, 2015, në Tiranë, Shqipëri, një vend që u deklarua me kushtetutë një shtet ateist në vitin 1967 dhe që tani lulëzon me kisha dhe ka liri fetare edhe pse ka ende diskriminim.
3. Konsultimi me titull: *“Diskriminim, persekutim dhe martirizim: Të ndjekim Krishtin së bashku!”* u mbledh nga Forumi i Krishterë Global së bashku me Këshillin Pointifik për promovimin e Unitetit të Krishterë (Kisha Romano-katolike) Shoqëria Botërore Pentikostale, Aleanca Botërore Ungjillore dhe Këshilli Botëror i Kishave. Ai u organizua në Shqipëri në bashkëpunim të ngushtë me Kishën Orthodhokse Autoqefale, Konferencën e Episkopëve Romano-katolikë dhe Aleancën Ungjillore.
4. Jemi mbledhur së bashku sepse diskriminimi, persekutimi dhe martirizimi mes të krishterëve dhe njerëzve të besimeve të tjera në botën e sotme por rritet për shkak të një sërë faktorësh të komplikuar në kontekste dhe realitete të ndryshme.
5. Ndërsa ndjekim Krishtin, të krishterët mund të ekspozohen ndaj çdo forme persekutimi, vuajtjeje dhe martirizimi për shkak se bota mëkatore është kundër Ungjillit të shpëtimit. Që nga kohët e lashta, të krishterët kanë përjetuar shpresën dhe realitetin e ngjalljes duke ecur në rrugën e kryqit. Së bashku ne ndjekim Krishtin “të uritur dhe të etur për drejtësi” për të gjithë. (Mateu 5:6)
6. Jeta e Kishës për shekuj ka qenë një dëshmi e vazhdueshme në dy mënyra: me shpalljen e Ungjillit të Krishtit dhe dëshminë me anë të derdhjes së gjakut të martirëve. Shekulli 21-të është plot me histori prekëse besimtarësh që kanë paguar për përkushtimin të Krishti me anë të vuajtjeve, torturave dhe ekzekutimeve. Martirët e krishterë na bashkojnë në mënyra të cilat zor se i imagjinojmë.
7. Ne e pranojmë që solidariteti mes kishave të krishtera është i domosdoshëm për të forcuar dëshminë e krishterë përballë diskriminimit, persekutimit dhe martirizimit. Në shekullin e 21-të ne duhet me urgjencë të forcojmë solidaritetin e të gjithë të krishterëve duke ndjekur atë që është arritur me vizion dhe dallim nga ky konsultim.
8. Pendo kemi për rastet kur kemi persekutuar njëri-tjetrin dhe të tjera komunitete fetare në histori dhe i kërkojmë ndjesë njëri-tjetrit dhe lutemi për mënyra të reja për të ndjekur Krishtin së bashku.

Në kungim me Krishtin, japim përkushtimin:

- a) **Të dëgjojmë më mirë** përvojat e të krishterëve, kishave dhe të gjithë atyre që diskriminohen dhe persekutohen dhe të angazhohemi më tepër për komunitetet në vuajtje.
 - b) **Të lutemi më tepër** për kishat, të krishterët dhe të gjithë ata që vuajnë diskriminim dhe persekutim, dhe në veçanti për transformimin e të gjithë atyre që diskriminojnë dhe persekutojnë.
 - c) **Të flasim më tepër** me respekt e dinjitet me zë të fortë e të qartë së bashku në përfaqësim të atyre që janë në vuajtje.
 - d) **Të bëjmë më tepër** në mirëkuptim reciprok për të gjetur mënyra efektive solidariteti dhe suporti për shërim, pajtim dhe liri fetare për të gjithë njerëzit e shtypur e të persekutuar.
9. Për të dëgjuar përvojën e atyre që po kalojnë kohëra sfide, duke u lutur dhe duke dalluar së bashku mënyra për të ndjekur Krishtin në këto realitete të vështira, konsultimi bën thirrje:
- a) **Të gjithë të krishterët** të përfshijnë më dukshëm në lutjet e tyre të përditshme ata të cilët po diskriminohen, persekutohen dhe vuajnë për përmbushjen e mbretërisë së Perëndisë.
 - b) **Të gjitha organizatat e krishtera, në nivel rajonal, kombëtar e lokal**, nga tradita të ndryshme të mësojnë, të luten dhe të punojnë së bashku në vendet e tyre për të persekutuarit, për t'i mbështetur më shumë ata.

- c) **Të gjitha Kishat** të angazhohen më tepër në dialog dhe bashkëveprim me komunitete të tjera besimi dhe të jenë “të mençur si gjarpërinjtë dhe të pastër si pëllumbat” (Mateu 10:16) duke mbetur vigjilent, syhapur dhe me guxim përballë diskriminimit dhe persekutimit.
- d) **Të gjithë persekutorët** që diskriminojnë dhe shtypin të krishterët dhe dhunojnë të drejtat e njeriut, të ndalin abuzimin e tyre dhe të afirmojnë të drejtën e të gjitha qënieve njerëzore për të jetuar dhe patur dinjitet.
- e) **Të gjitha qeveritë** të respektojnë e mbrojnë lirinë e besimit dhe të bindjeve të të gjithë popujve si një të drejtë njerëzore themelore. U bëjmë thirrje edhe qeverive dhe organizatave ndërkombëtare të respektojnë dhe mbrojnë të krishterët dhe të gjithë njerëzit vullnetmirë nga kërcënimet dhe dhuna e kryer në emër të besimit. Përveç kësaj, u kërkojmë atyre të punojnë për paqe dhe pajtim, të kërkojnë fashitjen e konflikteve të vazhdueshme dhe t’i japin fund rrjedhës së armëve veçanërisht të dhunuesit e të drejtave të njeriut.
- f) **E gjithë media** të raportojë në mënyrë të përshtatshme dhe të paanshme mbi dhunimet e lirisë fetare përfshirë diskriminimin dhe persekutimin e të krishterëve si dhe të komuniteteve të tjera të besimit.
- g) **Të gjitha institucionet arsimore** të zhvillojnë mundësi dhe mjete t’i mësojnë të rinjtë veçanërisht për të drejtat e njeriut, tolerancën fetare, shërimin e kujtimeve dhe armiqësive të së shkuarës si dhe mjetet paqësore të pajtimit dhe zgjidhjes së konflikteve.
- h) **Të gjithë njerëzit vullnetmirë** të punojnë për drejtësi, paqe dhe zhvillim duke ditur që varfëria dhe përçmimi i dinjitetit njerëzor janë faktorët kryesorë që shtojnë dhunë.
10. Rekomandojmë që Forumi i Krishterë Global të vlerësojë brenda dy viteve punën e këtij eventi dhe raportet drejtuar të katër grupeve në mënyrë që ato të ndjekin.

Perëndia Atë, që me birin e Tij na krijoi të barabartë, forcoftë përpjekjet tona për të kapërcyer çdo formë diskriminimi dhe persekutimi.

Shpirti i Tij i Shenjtë na udhëbeqtë në solidaritet me të gjithë ata që kërkojnë paqe dhe pajtim.

I shëroftë Ai plagët e të persekutuarve dhe na dhëntë shpresë në pritjen tonë të ardhjes së lavdishme të Zotin tonë, Jisu Krisht, i cili do t’i bëjë të reja të gjitha gjërat.